

RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR FËMIJËT NË SITUATË RRUGE

Periudha raportuese Janar - Mars 2016

RAPORT PERIODIK PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR FËMIJËT NË SITUATË RRUGE

Periudha raportuese Janar-Mars 2016

Hyrje

Plani i Veprimit për Fëmijët në Situatë Rruge 2015-2017, i miratuar me Marrëveshjen 3 Ministrore mes MMSR, MAS dhe MPB, përcakton objektivat dhe veprimet në nivel qendror dhe vendor në ndihmë të fëmijeve në situatë rruge.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve monitoron dhe raporton periodikisht lidhur mbi zbatimin e këtij Plani. Raporti 3 muajor **Janar-Mars 2016** është hartuar në bazë të raportimeve periodike të punës që është bërë në 4 bashkitë e përfshira, Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier. Lidhur me këtë falenderojmë Berthamën koordinuese dhe Njësitet e Mbrojtjes së Fëmijëve të bashkive të përfshira për kontributin dhe bashkëpunimin.

Gjatë periudhës raportuese plani është zbatuar në 4 bashkitë Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Fier të cilat kanë prej mëse një viti që punojnë për zbatimin e planit.

Gjate periudhës janar - mars 2016 është punuar për përfshirjen në zbatim të planit të veprimit për fëmijë në situatë rruge dhe tre bashki të tjera ;bashkitë Vlorë, Korçë dhe Shkodër .

Raporti përmban të dhëna narrative dhe në shifra , lidhur me punën identifikuese në terren dhe menaxhimin dhe mbështetjen e rasteve nga strukturat shtetërore dhe partneret publike dhe jopublike që bashkëpunojnë në zbatim të Plan Veprimit për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.

1. Puna e skuadrave të terrenit

Në bashkitë Tiranë, Durrës, Fier dhe Elbasan funksionojnë **19 skuadra terreni** të cilat identifikojnë rastet e fëmijëve në situatë rruge sipas kalendarit të hartuar dhe ndarë me aktorët.

➤ Në bashkinë Tiranë

Funksionojnë **11 skuadra terreni** të cilat identifikojnë dhe referojnë raste të fëmijëve në situatë rruge sipas kalendarit të hartuar muajor të ndarë me aktorët nga Bashkia Tiranë.

Në muajin janar, pjesë e skuadrave të terrenit kanë qenë NJMF-të përkatëse të Njësive Administrative, një punonjës social nga OJF partnere në zbatimin e Planit të Veprimit (ARSIS,

SHKEJ, FBSH, Të Ndryshëm & të Barabartë, Save the Children) dhe punonjës të Qendrës Komunitare Shkozë.

Në muajin shkurt për arsye të ristrukturimit të stafeve të tetë NJMF(NJMF Nr 1, NJMF Nr 2, NJMF Nr 3, NJMF Nr 4, NJMF Nr 5, NJMF Nr 8, NJMF Nr 10, NJMF Nr 11) Bashkia Tiranë mori masa në vijimësinë e funksionimit të skuadrave të terrenit duke angazhuar punonjësit social të Qendrave Sociale të Bashkisë Tiranë. Stafet e Qendrave Sociale paraprakisht u trajnuan mbi procedurat e vlerësimit dhe referimit të fëmijëve në situatë rruge, dhe për bazën ligjore lidhur me fëmijët në situatë rruge. Trajnimi u realizua nga Bashkia Tiranë dhe Organizata ARSIS.

Në muajt shkurt - mars skuadrat e terrenit përbëheshin nga punonjësit e NJMF Nr 6,7,9, punonjës social të organizatave dhe punonjës të qendrave sociale të Bashkisë Tiranë. Ekipi bërthamë i ngritur pranë ASHDMF ka realizuar dalje në terren gjatë orareve të paradites në mbështetje të skuadrave të terrenit të bashkisë Tiranë.

Duke filluar nga muaji Mars janë bërë ekipi bërthamë ka mbuluar vizitat në terren në orët e **pasdites dhe në fundjava duke realizuar 14 dalje në terren** në zonat më të "nxehta" për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge. Në këto dalje në terren janë identifikuar 9 fëmijë në situatë rruge. Rastet e identifikuara janë referuar në Bërthamën koordinuese në bashkinë Tiranë.

Monitorimi i terrenit kryhet edhe në oraret e mbasdites (18.00-20.00) dy herë gjatë javës si dhe në fundjavë të shtunën paradite vetëm nga ekipi i bërthamës në zonat e nxehta si: Rruga e Elbasanit, Blloku ,Vasil Shanto, 21 dhjetori.

Nga skuadra e terrenit janë realizuar për periudhën janar-mars gjithësej rreth **181 dalje** në terren. Gjatë kësaj periudhe skuadrat e terrenit kanë identifikuar **54 raste** të reja të fëmijëve në situatë rruge.

➤ **Në bashkinë Durrës**

Aktualisht është aktive **1 skuadër** terreni e cila përbëhet nga NJMF e bashkisë Durrës dhe Shërbimi Social Rajonal. Gjatë periudhës janar-shkurt në këtë bashki nuk është realizuar asnjë dalje në terren për shkak të mosmbështetjes nga Organizatat në burime njerëzore për plotësimin e skuadrave të terrenit. Gjatë muajit mars janë realizuar **5 dalje në terren** ku janë identifikuar **7 fëmijë** në situatë rruge.

➤ **Në bashkinë Elbasan**

Janë ngritur **3 skuadra** terreni të cilat përbëhen nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës në këtë bashki dhe anëtarë të organizatave. Skuadrat e terrenit kanë realizuar **45 dalje në terren** gjatë orarit 8:00-16:00. Nuk ka pasur dalje në terren në orët e pasdites.

Skuadrat kanë realizuar daljet duke zbatuar kalendarin e miratuar nga Drejtoria e shërbimit social pranë kësaj bashkie. Nga vëzhgimi në terren vërehet një ulje e numrit të fëmijëve në situatë rruge. Në periudhën janar – mars është **identifikuar 1 rast** i ri në situatë rruge.

➤ **Në bashkinë Fier**

Janë ngritur **2 skuadra** terreni të cilat bëjnë identifikimin në terren. Skuadrat e terrenit përbëhen nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës pranë bashkisë Fier, një punonjës i kësaj bashkie i cili flet gjuhën rome dhe anëtarë të Organizatës Terre des Hommes e cila vepron në Fier.

Gjatë periudhës janar- mars 2016 ka një ulje të numrit të fëmijëve në situatë rruge. 2 skuadrat e Terrenit kanë realizuar **27 dalje në terren** gjatë orarit 8:00-16:00 dhe **5 dalje në terren** gjatë orareve të pasdites. Daljet në terren janë bërë duke zbatuar kalendarin e miratuar nga Drejtoria e Shërbimit Social , Bashkia Fier.

Gjatë daljeve në terren janë **identifikuar 3 raste të reja** të cilët kanë marrë shërbime. Një fëmijë në situatë rruge është identifikuar në orarin e pasdites të cilit i është ofruar shërbimi i emergjencës.

2. Puna koodinuese dhe Funkionimi i Grupeve Teknike Multidisiplinare

Në bashkitë e përfshira rastet menaxhohen përmes punës së grupit multidisiplinar në bazë të udhëzimit 4 ministror Nr.10 datë 25.2.2014 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.

➤ **Në bashkinë Tiranë**

Për bashkërendimin e punës mes Agjencisë së Fëmijëve dhe Bashkisë Tiranë për fëmijët në situatë rruge, është përgatitur një plan pune. Në këtë plan janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e dy institucioneve për fëmijët në situatë rruge. Bashkia Tiranë koordinon daljet skudrave të terrenit dhe përgatit çdo muaj kalendarin e daljeve në terren të cilin e shpërndan tek të gjithë aktorët. ASHMD vihet në dijeni nga Bashkia Tiranë për kalendarin dhe databazën e përditësuar për fëmijët në situatë rruge një herë në muaj.

Për ecurinë e këtij plani u realizua në mujain Mars 2016 një takim mes ASHMDF, Bashkisë Tiranë dhe Zyrës së Punës ku u diskutuan rastet problematike të familjeve të fëmijëve në situatë rruge dhe referimet e bëra për punësim për vitin 2016.

ASHMD koordinon takimin mujor mes Bashkisë Tiranë dhe Zyrës së Punës për të diskutuar mbi ecurinë e rasteve të menaxhuara nga NJMF, problematikat e hasura në identifikimin dhe menaxhimin e rasteve në terren dhe mbi çështjen e punësimit.

Aktorët e grupeve teknike multidisiplinare janë mbledhur sipas rasteve problematike që kanë trajtuar NJMF-të. Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ka koordinuar takimin me përfaqësues nga Policia, Zyra e Punës, Punonjës të Njësive administrative dhe Organizata që ofrojnë shërbime për fëmijët në nevojë.

PNJMF të **Bashkisë Tiranë** vazhdojnë punën për mbështetjen e fëmijëve në situatë rruge dhe familjeve tyre përmes mbledhjeve të Grupeve Teknike Multidisiplinare. Për periudhën janar-mars janë menaxhuar **17 raste** në situatë rruge nëpërmjet mbledhjes së Grupeve Teknike Multidisiplinare. Për periudhën janar- mars janë mbajtur **4 Grupe Teknike Multidisiplinare**.

Shërbimet e ofruara : regjistrim në gjendjen civile të fëmijëve, plotësimin e dokumentave për akomodimin në çerdhe/kopsht, referim në skemën e ndihmës ekonomike, transferim i gjëndjes civile, ofrim i paketave ushqimore, referim për punësim, frekuentim i qendrave ditore e komunitare.

Punësimi: Për punësimin e familjeve në situatë rruge ndërmjetëson ekipi i punësimit të Zyrës së punës që mundëson përshtatjen e vendit të punës me aftësitë e individëve, por dhe duke respektuar dëshirat dhe mundësitë e tyre.

Për periudhën janar-mars : **16 raste** janë referuar për punë, **11 raste** janë punësuar në sektorin privat kryesisht pranë kompanive të pastrimit, fasoneri dhe shërbime. Por ka pasur dhe raste refuzimi dhe braktisje të vendit të punës: **3 raste** kanë refuzuar pozicionin e punës gjatë intervistës së bërë në subjekt dhe **2 raste** e kanë braktisur punën. **10 të rinj** janë referuar në Formim Profesional .

➤ **Në bashkinë Durrës**

Janë bërë **3 takime** të Grupeve Teknike Multidisiplinare ku të gjithë aktorët iu kanë përgjigjur ftesës. Në këto takime janë diskutuar **5 raste të fëmijëve** në situatë rruge.

Shërbimet e ofruara: Referim në skemën e ndihmës ekonomike dhe monitorim i fëmijëve, sistemim i fëmijës në institucion, regjistrim në gjendjen civile të fëmijës.

Problematika:

- Në këtë bashki ka mungesa të shërbimeve ku më të theksuarat janë në mosfunksionimin e skuadrave të terrenit pasi nuk ka bashkëpunim mes NJMF dhe organizatave që punojnë në këtë bashki.
- Mungojnë qendra sociale dhe komunitare për t'i ofruar shërbimet fëmijëve në situatë rruge dhe familjeve në nevojë. Në këtë bashki është funksionale vetëm një qendër komunitare.

➤ **Në bashkinë Elbasan**

Gjatë periudhës janar- mars 2016 është identifikuar **vetëm një rast i ri** i fëmijës në situatë rruge. Gjatë kësaj periudhe NJMF ka punuar për **menaxhimin e 20 rasteve** të cilat janë identifikuar gjatë vitit 2015. Nuk ka pasur fëmijë në situatë rruge të shoqeruar në shërbimet shëndetësore apo shërbimet e emergjencës dhe të referuar për ndjekje penale.

Falë punës së skuadrave të terrenit dhe të gjithë aktorëve të tjerë që punojnë në këtë bashki në mbrojtje të fëmijëve në situatë rruge, vërehet një ulje e numrit të fëmijëve në situatë rruge.

Në këtë bashki janë realizuar **5 takime** me GTM ku janë diskutuar rastet më problematike që po menaxhon NJMF.

Sipas raportimeve të NJMF të gjithë aktorët kanë marrë përsipër zbatimin e detyrave të përcaktuara. Në rastet e menaxhuara në këtë periudhë rol shumë të rëndësishëm kanë luajtur Organizatat **A2B, Tjetër Vizion dhe NE.**

Shërbimet e ofruara: ofrim i ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë, ndihma në pako ushqimore, ndihma mjekësore(hapje libreze shëndeti); referim në qendrën A2B për të marrë shërbimin e drekës falas, mbështetje në pagesën e qerasë nga A2B për një familje.

Problematika:Në bashkinë Elbasan është punuar shumë me fëmijët në situatë rruge dhe me familjet e tyre por ekzistojnë edhe problematika të cilat e vështirësojnë punën e aktorëve. Ndër to renditen:

- Zhvendosja e familjeve nëpër qytete të tjera. Shumë familje të komunitetit rom dhe egjiptian në periudha të ndryshme të vitit lëvizin nëpër qytete të tjera të Shqipërisë. Menaxhimi i këtyre familjeve është shumë i vështirë.
- Problematike tjetër është vështirësia për të bashkëpunuar me familjet e fëmijëve në situatë rruge, kjo pasi ata nuk e kuptojnë përgjegjësinë penale për përdorim apo shfrytëzim të fëmijëve për lypje dhe detyrimin prindëror për të siguruar të drejtat e tyre.
- Një sfidë tjetër e NJMF në bashkinë Elbasan është gjetja e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe afatgjatë për familjet si : punësimi, formimi profesional.

➤ **Në bashkinë Fier**

Lidhur me monitorimin e rasteve të fëmijëve të regjistruar në shkollë NJMF ka bashkëpunuar me Observatorin për të drejta të fëmijëve. Problem mbeten fëmijët të cilët rregjistrohen në shkollë por nuk e frekuentojnë rregullisht dhe ata fëmijë që kanë emigruar në shtetet e tjera nuk deklarohen nga Drejtoria Arsimore Rajonale.

Bashkëpunimi me Zyrën juridike në Bashki paraqitet problematike, pasi kjo zyrë nuk jep asistencë juridike kur kërkohet nga NJMF. Agjencia ka mundësuar lidhjen e kontakteve mes NJMF dhe organizatës TLAS për të pasur asistencë juridike falas nga kjo organizatë.

Bashkëpunimi me Zyrën e Punës nuk ka rezultuar shumë produktiv pasi kjo e fundit nuk është shumë e gatshme për të ndërmjësuar për punësimin e kësaj kategorie në biznese të ndryshme

Nga identifikimi në terren i fëmijëve në situatë rruge, nga skuadrat e terrenit të ngritura pranë kësaj bashkie, **3 fëmijë** janë shoqëruar në shërbimet shëndetësore. Së bashku me rastet e mëparshme, NJMF e kësaj bashkie ka menaxhuar **29 raste fëmijësh**. Gjatë kësaj periudhe është bërë e mundur largimi i **2 fëmijëve** nga rruga si rezultat i punës së bërë nga të gjithë aktorët për rritjen e cilësisë së jetës së këtyre familjeve.

NJMF e bashkisë Fier ka mbledhur **6 Grupe** Teknike Multidisiplinare ku pjesëmarrës kanë qenë përfaqësues të Terre des Hommes, përfaqësues të Policisë dhe përfaqësues të Shërbimit Social Bashkisë Fier. Në mbledhjet e GTM nuk janë paraqitur përfaqësues të gjykatës dhe prokurorisë.

Shërbimet e ofruara: këshillim, asistencë për integrimin në skemën e ndihmës ekonomike, asistencë për shërbime shëndetësore, mbështetje për integrim në kurse profesionale falas dhe këshillim në hapjen e një biznesi.

Problematika

- Mungesa e një fondi emergjence për tu përdorur për rastet specifike si për fond transporti, blerje ilaçesh apo ushqimesh.
- Mungojnë qendrat komunitare të cilat ofrojnë shërbime për këtë targetgrup sidomos në zonën e Levanit. Për menaxhimin e fëmijëve në situatë rruge apo dhe marrjen në mbrojtje të menjëherëshme nevojitet një qendër emergjence.

3. Bashkëpunimi me policinë

➤ Në bashkinë Tiranë

Bazuar në raportimet e NJMF konstatohet që ka funksionuar bashkëpunimi me policinë e shtetit. Bashkëpunimi ka qenë në rastet kur është kërkuar nga skuadrat e terrenit dhe policia është treguar e gatshme dhe bashkëpunuese në identifikimin e rasteve në zonën e 21 Dhjetorit dhe Rugën e Elbasanit. Për këtë periudhë raportohen dhe për dy raste problematike të rrugës së “Elbasanit” të referuar nga skuadra e terrenit në polici për ndjekje penale. Nisur nga përvoja dhe bashkëpunimi me policinë gjatë punës në terren, ASHMDF kërkoi nga Drejtoria e Policisë bashkëpunim për të shoqëruar në daljet në terren për muajin prill skuadrat e terrenit. Në muajin mars është draftuar kalendari dhe është dërguar për mendim pranë Drejtorisë së Policisë, Koordinatorit Antitrafik dhe Bashkisë Tiranë.

➤ Në bashkinë Durrës dhe Elbasan

Në këto bashki nuk ka pasur raste referimi në polici në lidhje me fëmijët në situatë rruge. Nga ASHMDF është rekomanduar që punonjës të policisë të jenë pjesë e skuadrave të terrenit. Por konsatohet se edhe pse janë të përfshirë në kalendaret e skuadrave të terrenit, nuk kanë bërë dalje në terren.

➤ **Në bashkinë Fier**

Policia ka bashkëpunuar me NJMF për raste e identifikuar duke u përgjigjur në të gjitha rastet që thirret nga NJMF në takimet me GTM dhe në grupet e terrenit por është problematik fakti që inspektorët e terrenit nuk janë shumë të informuar në lidhje procedurat e punës për fëmijët në situatë rruge. Pika e kontaktit e policisë është zëvendësuar me një tjetër person me të cilën u kontaktua gjithashtu.

ASHMDF ka realizuar një takim me drejtorin e policisë në qarkun Fier dhe specialistes për fëmijet në polici. Në takim u diskutua mbi rëndësinë e policisë në përbërjen e skuadrave të terrenit dhe u sugjerua të kryhet një takim mes NJMF dhe specialistes së sapoemëruar në këtë drejtori për të bërë më të qartë rolet e aktorëve në zbatimin e planeve lokale për fëmijët në situatë rruge.

Gjatë 3 mujorit të parë të 2016 ka pasur një rast ku skuadra e terrenit ka shoqëruar një fëmijë në situatë rruge në komisariat. Pas identifikimive të bëra nga punonjës të policisë, fëmija është kthyer në familje.

4. Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndërminstrore mes Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve datë 12.06.2015. nr prot.3430 dhe Planit Kombëtar të Veprimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge” 2015-2017, ASHMDF ka përgjegjësi të monitorojë zbatimin e këtij plani.

Agjencia ka hartuar një plan monitorimi në bashkitë e përfshira, ku është përcaktuar që çdo muaj do të monitorohet të paktën një nga bashkitë e përfshir. Plani i hartuar është miratuar nga kryetarja e Agjencise. Monitorimi bëhet në bazë të një formulari të monitorimi bazuar në planin e veprimit si mjet për monitorimin.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2016 janë realizuar 4 monitorime të punës së NJMF me fëmijët në situatë rruge, përkatësisht në Bashkitë (Tiranë – Njësitë Administrative Nr.3 dhe Nr.4, Bashkia Durrës dhe Bashkia Fier).

Në secilën prej Njërive u monitorua dokumentacioni që disponon NJMF në dosjet e fëmijëve në situatë rruge dhe puna e tyre në menaxhimin e rasteve. Për çdo monitorim të kryer është dërguar shkresë zyrtare kryetarit të bashkisë përkatëse me rekomandime. Rekomandimet kanë kosistuar në zbatimin e procedurave për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik si dhe përmirësimin e bashkëpunimit mes institucioneve dhe OJF. Për bashkinë Durrës është rekomanduar që të zbatohet planin e daljeve në terren dhe të marrin masa parandluese për sezonin e verës.

5. Databaza e fëmijëve në situatë rruge

Cdo fillim muaji Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dërgojnë në mënyrë elektronike databasën e përditësuar me rastet e identifikuara në situatë rruge dhe hapat e ndermarra në menaxhimin e tyre. ASHDMF disponon një databazë qendrore në të cilën përditësohen të gjitha rastet që vijnë nga bashkitë Durrës, Elbasan, Fier dhe Tiranë.

Në fund të muajit Mars modeli i databazës i është nisur bashkive në të cilat po shtrihet plani i veprimit për fëmijët në situatë rruge : Shkodër, Vlorë, Koçë.

Me qëllim parandalimin e lëvizjeve të fëmijëve nga një qytet në tjetrin për të lypur apo punuar, nga databaza qendrore që Agjencia disponon, janë identifikuar këto raste dhe janë referuar në NJMF e bashkive ku ata kanë vendbanimin. Me rastet e identifikuara, NJMF e bashkive së bashku me punonjës të organizatave dhe policisë do të bëjnë vizita në komunitetet e tyre me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për të mos lëvizuar nga një qytet në tjetrin për të lypur por marrë punësim dhe shërbime në vendin ku jetojnë .

6. Zgjerim i planit të veprimit dhe hartimi i planeve lokale në bashkitë Korçë, Vlorë, Shkodër

Në zbatim të Planit të Veprimit është planifikuar gjatë 2016 zgjerimi i planit me tre bashki të tjera (Shkodër, Vlorë, Korçë). Këto bashki kanë qenë prioritet për shkak të fenomenit të gjerë të fëmijëve në situatë rruge në shkallë kombëtare. Agjencia ka nxitur hartimin e planeve lokale për fëmijët në situatë rruge në këto bashki. Aktualisht janë draftuar planet lokale të bashkitë Korçë, Vlorë, Shkodër.

Gjatë muajit Shkurt janë bërë takime me profesionistë të **bashkive Vlorë dhe Korçë** ku është prezantuar draftplanin lokal për fëmijët në situatë rruge në këto bashki. Këto takime u organizuan me specialistë të Ekipit bërthamë nga ASHDMF dhe konsulentët e OSBE. Perfaqësuesit vendorë konsultuan planin duke dhënë komentet e tyre për draft planet lokale.

Në bashkinë **Shkodër**, takimi në lidhje me diskutimin e draftplanit lokal u realizua në Mars 2016. Ku u shoqërua dhe me një takim mes drejtorit të kujdesit social në këtë bashki dhe ASHDMF ku u diskutua bashkëpunimi i mëtejshëm mes bashkisë Shkodër dhe Agjencisë për menaxhimin e fëmijëve në situatë rruge.

Planet lokale priten të zyrtarizohen në tremujorin e dytë të vitit 2016 por puna e skuadrave të terrenit do të fillojë më datë 1 prill 2016. NJMF e 3 bashkivë kanë nisur kalendarin e daljeve në terren për muajin prill dhe përbërjen e skuadrave të terrenit.

7. Trajnime

Me synim trajnimit e aktorëve të përfshirë në zbatim të planit të veprimit janë zhvilluar trajnimet e me profesionistë të bashkive të reja që po përsihen në zbatim të planit.

Për tu ardhur në dihmë profesionistëve për punën me fëmijë në situatë rruge është hartuar dhe publikuar me mbështetjen e OSBE një Udhëzim i proceduarave për fëmijët në situatë rruge që do tu shërbejë për të gjithë profesionistët që punojnë për fëmijët duke ofruar një qasje të integruar, proaktive brenda sistemit aktual të mbrojtjes së fëmijëve.

Gjatë periudhës Janar- Mars 2016 janë realizuar trajnime për udhëzuesin në tre bashkitë e përfshira Shkoder, Korce, dhe Vlorë.

Gjitashtiu janë organizuar dhe trajnime me qëllimi ngritjen e kapaciteteve të aktorëve lokal dhe të përfaqësuesve të organizatave që operojnë pranë tyre . Në periudhën janar mars janë zhvilluar këto trajnime :

- *Workshope për gartimin e planeve lokale në bashkite e perfshira*
- *“Puna ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve në Shëqipëri”*
- *Trajnim i skuadrave të terrenit për identifikimin dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge*

Në këto trajnime e dhe workshope ka pasur një angazhim dhe interes të madh nga aktoret dhe profesionistët duke nxjerrë dhe problematikat dhe sfidat për punën me fëmijët në situatë rruge. Përfaqësues të Agjencisë dhe ekspertë të mbështetur nga OSBE kane konsultuar aktorët mbi këto problemetika e sfida.

8. Fushata ndërgjegjesuese

Pjesë e punës për fëmijët në situatë rruge është planifikimi i fushatës ndërgjegjesuese “Asnjë fëmijë në rrugë për punë apo lypje” të lancuar në 12 prill, ditën nderkombëtare të fëmijëve në situatë rruge. Fushata do të zgjasë 3 muaj dhe do të shtrihet në 7 bashkitë e përfshira. Ekipi berthame i agjencise ka bashkepunuar me bashkitë e përfshira për të finalizuar flyer-in që do të përdoret në fushatë i cili ka funksion informues dhe ndërgjegjesues për qytetarët dhe bizneset. Agjencia ka siguruar printimin e 2000 fletepalosjeve dhe i ka shperndarë ato në bashkitë e përfshira të cilat do të zhvillojnë fushatën në muajt në vazhdim.

Të dhëna në total qershor 2014 – mars 2016

Bashkia	Nri sk. terrenit	Rastetëiden tifikuar	Raste të menaxhuar	Raste referuar të regjistrim në shkollë		Raste referuar për kopsht		Raste referuar ne arsim profesional	Raste referuar për çerdhe		Rastetndermjetesuar per punesim		Rastepërndjekjenale
				referuar	Regjistruar	referuar	regjistruar		referuar	regjistruar	referuar	Punesuar	
Durrës	1	85	37	9	7		1						
Elbasan	4	41	32	11	8	3	3				5	1	1
Fier	3	25	14	32	13						3		
Tiranë	11	425	186	232	63	38	14	10	47	11	159	88	19
Total	19	479	269	284	91	41	18	10	47	11	167	89	20

Të dhënat tremujore janar- mars 2016

Bashkia	Nr I sk. terrenit	Rasterej atëidenti fikuar	Raste të menaxhuar	referuar regjistruar në shkollë	referuar regjistruar për kopsht	Raste referuar për çerdhe	Raste referuar ne arsim profesional	Rastetndermjetesuar per punesim		Rastepërndjekjenale
								referuar	Punesuar	
Durrës	1	7	5	-	-	-	-	-	-	-
Elbasan	3	1	1	-	-	-	-	-	-	-
Fier	2	3	3	-	-	-	-	-	-	1
Tiranë	11	54	17	-	-	-	10	16	11	2
Total	19	65	26	-	-	-	10	16	11	3